

Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr. 08/L-025 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/2022), nenit 17 pika e) neni 40.2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 15 pika c, të Statutit të Komunës së Gjakovës, Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur më XX.XX.2023 miraton:

RREGULLORE KOMUNALE Nr. __/2022 PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e Komunës së Gjakovës për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjithë personave fizikë dhe juridikë, aktivitetet e të cilëve në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë e ndotin ajrin në territorin e komunës Gjakovës si dhe ndaj të gjitha autoriteteve publike dhe private të cilat kryejnë veprimtarinë e monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimin e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e sistemit matës për matjen e vazhdueshme të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme në territorin e komunës xx.

Neni 3 Përkufizimet

1. Përkufizimet në këtë rregullore janë të njëjtat sikurse janë përcaktuar në Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

KAPITULLI II PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS

Neni 4

Kompetencat e komunës për mbrojtjen e ajrit

1. Komuna brenda kompetencave të paraparë me ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe aktet tjera nënligjore siguron efektivitetin e mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit dhe të shtresës së ozonit, zbutja dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.
2. Kushtet për monitorimin e cilësisë së ajrit, monitorimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër nga burimet e palëvizshme, kontrollimin e sistemit matës për matjet kontinuale të emisioneve nga burimet e palëvizshme që janë në kompetencë të komunës janë të përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të kësaj rregullore.

KAPITULLI III MONITORIMI DHE VLERËSIMI I CILËSISË SË AJRIT

Neni 5

Monitorimi i cilësisë së ajrit nga komuna

1. Komuna vendos stacionet për monitorimin e cilësisë së ajrit në territorin e vet, kur vlerësonë se shkalla e ndotjes është më e madhe se vlerat e përcaktuara kufitare, për arsye të rritjes dhe zhvillimit të industrisë apo zgjerimit të zonave punuese.
2. Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për mjedis, cakton lokacionet e stacioneve matëse për monitorimin e cilësisë së ajrit në konsultim me Ministrinë, përgatitë programin e matjeve të shkallës së ndotjes dhe siguron kushtet për zbatim.
3. Drejtoria Për Urbanizëm Dhe Mbrojtje Të Mjedisit kryen mbikëqyrjen për zbatimin e obligimeve nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni dhe të dhënat nga matjet e kryera i publikon në ueb faqen e Komunës.
4. Drejtoria Për Urbanizëm Dhe Mbrojtje Të Mjedisit ia paraqet AMMK-së të dhënat bazë dhe të validuara për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe raportin për nivelet e ndotjes dhe vlerësimin e cilësisë së ajrit deri më 30 mars të vitit aktual, për vitin e kaluar kalendarik.

Neni 6
Monitorimi i cilësisë së ajrit nga ana e
operatorëve ekonomik në territorin e komunës

1. Operatori ekonomik, është i obliguar të siguroj monitorimin e cilësisë së ajrit sipas vendimit për Leje Mjedisore Komunale, në pajtim me legjislacionin përkatës.
2. Personi juridik – laborator testues dhe kalibruar i cili kryen matjet për operatorin e caktuar është i obliguar t’ia dorëzoj Komunës, të dhënat bazë dhe të validuara të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe raportin për shkallën e ndotjes dhe vlerësimit të cilësisë së ajrit deri më 31 mars të vitit aktual, për vitin e kaluar kalendarik

Neni 7
Tejkalimi i vlerave kufitare

1. Në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar dhe i lajmëruar nga ana e qytetarëve, se ka ardhur deri te ndotja e ajrit, cilësia e të cilit mund të rrezikojë shëndetin e njerëzve, cilësinë e jetës dhe do të ndikojë negativisht në cilëndo qoftë pjesë të mjedisit, brenda 8 (tetë) orëve duhet të kryhen matjet e veçanta ose të bëhet vlerësimi i shkallës së ndotjes nga **drejtoria përkatëse** e komunës.
2. **Drejtoria përkatëse e Komunës** vërteton arsyeshmërinë e dyshimit nga paragrafi 1 i këtij neni dhe merr vendim për matje të veçanta me përmbajtje dhe kohëzgjatje të matjeve për vlerësimin e shkallës së ndotjes si dhe mënyrën e pagesës së matjeve të veçanta të vlerësimit të shkallës së ndotjes dhe e njofton Ministrinë.
3. Nëse me matje ose vlerësim vërtetohet se nuk ka ardhur deri te tejkalimi i ndotjes ose ka ndotje të tejkaluar dhe ndotësi nuk është identifikuar, shpenzimet i bartë Komuna, e cila ka marrë vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Nëse me matje ose vlerësim vërtetohet tejkalimi i shkallës së ndotjes së ajrit dhe ndotësi është i identifikuar, shpenzimet e matjeve apo të vlerësimit, i bartë ndotësi, sipas vendimit nga paragrafi 2, të këtij neni.
5. Komuna me kërkesë të inspektorit mjedisor për vërtetimin e arsyeshmërisë së dyshimit nga paragrafi 1, të këtij neni, obligohet të marr vendimin për matje të veçanta ose vlerësim të shkallës së ndotjes në afat prej tri (3) ditësh.
6. Nëse komuna nuk merr vendim sipas paragrafit 5 të këtij neni, Ministria siguron matjet e veçanta ose vlerësimet e shkallës së ndotjes në llogari dhe përgjegjësi të Komunës.

KAPITULLI IV
MASAT PËR PARANDALIMIN
DHE ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË AJRIT

Neni 8

Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit

1. Parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit në territorin e komunës realizohet me
 - 1.1. harmonizimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivel lokal me dokumentet strategjike dhe planet e nivelit qendro dhe lokal për cilësi të ajrit.
 - 1.2. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit të përcaktuara në vendimin Lejes Mjedisore komunale;
 - 1.3. sigurimin e buxhetit për zbatimin e masave të efijencës së energjisë;
 - 1.4. zbatimin e masave nga Plani Lokal i Veprimit dhe Plani Afatshkurtër i Veprimit.

KAPITULLI V
PLANIFIKIMI I MBROJTJES SË AJRIT

Neni 9

Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit

1. Nëse vlerësohet se nivelet e ndotësve në ajër tejkalojnë vlerat kufitare ose të synuara, komuna harton Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit, për periudhën pesë (5) vjeçare me qëllim të arritjes së vlerave kufitare ose të synuara.
2. Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit mund të përfshijë edhe masa shtesë të duhura, me qëllim të mbrojtjes së grupeve të ndjeshme të popullatës.
3. Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit përmban:
 - informatat e përgjithshme,
 - analizën e gjendjes,
 - llojin dhe vlerësimin e ndotjes,
 - përcaktimin e vendit të ndotjes së lartë,
 - prejardhjen e ndotjes, masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit,
 - detajet e masave të përcaktuara,
 - prioritizimin e tyre,
 - afatet e përmbushjes së masave,
 - vlerësimin e resurseve financiare dhe
 - autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave.
4. Gjatë hartimit të Planit nga paragrafi 1 i këtij neni, komuna ia dorëzon Ministrisë draftin për dhënie të komenteve.

5. Pas miratimit të Planit nga paragrafi 1 të këtij neni, komuna ia dorëzon atë Ministrisë.
6. Komuna është e obliguar t'i zbatojë dhe financojë masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit të parapara në Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit.
7. Ndotësit janë të obliguar t'i zbatojnë dhe financojnë masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit të parapara në Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit

Neni 10

Plani Afatshkurët i Veprimit

1. Nëse në territorin e komunës ekziston rreziku nga tejkalimi i pragut të alarmit të ndotjes, komuna harton Planin Afatshkurtër të Veprimit, i cili përmban masat që duhet të ndërmerren në afat të shkurtër, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut dhe/ose uljes së ndotjes.
2. Plani Afatshkurtër i Veprimit nga paragrafi 1 i këtij neni, varësisht nga rastet individuale, mund të parasheh masat efektive të kontrollit dhe ku është e nevojshme, të ndaloj veprimtaritë të cilat shkaktojnë rrezik të tejkalimit të vlerave kufitare, vlerave të synuara ose pragut të alarmit.
3. Plani Afatshkurtër i Veprimit mund të përfshijë masa lidhur me:
 - qarkullimin e mjeteve motorike,
 - veprimtaritë ndërtimore,
 - punën e stabilimenteve industriale,
 - përdorimin e prodhimeve industriale,
 - ngrohjen në amvisëri dhe
 - t'i parasheh edhe veprimtaritë specifike, me qëllim të mbrojtjes së grupeve të ndjeshme të popullatës.
4. Komuna informonë publikun, përfshirë palët e interesuara për rezultatet e kërkimeve të bëra, realizimin dhe përmbajtjen e Planit Afatshkurtër të Veprimit si dhe zbatimin e këtij plani.
5. Ndotësi është i obliguar t'i zbatoj dhe financoj masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, të përcaktuara në Planin Afatshkurtër të Veprimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 11

Raporti për Realizimin e Planeve të Veprimit

1. Me qëllim të monitorimit të arritjes së objektivave të Planeve të përmendura në neni 9 dhe 10 të kësaj rregulloreje, si dhe pasqyrës së gjendjes së cilësisë së ajrit komuna përgatit Raporti i Realizimit të Planit për një periudhë një (1) vjeçare.
2. Raporti për realizimin e Planeve të Veprimit përmban:
 - 2.1. gjendjen e cilësisë së ajrit: informatat për territorin, nivelin e ndotjes, qëndrueshmëria e niveleve të caktuara të ndotjes, llojet dhe vlerësimet e ndotjes, prejardhjen e ndotjes, analizën e faktorëve të cilët kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, të dhënat për masat e ndërmarra dhe projektet për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
 - 2.2. vlerësimin e masave të realizuara dhe ndikimet e tyre;
 - 2.3. realizimin e masave të planit, programit dhe dokumenteve të tjera për mbrojtjen e cilësisë së ajrit;
 - 2.4. të dhënat për ndëshkimet e shqiptuara;
 - 2.5. të dhënat për shfrytëzimin e mjeteve financiare për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;
 - 2.6. propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e dokumenteve ekzistuese si dhe të dhënave të tjera me rëndësi për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
3. Raportin për zbatimin e planit të veprimit të cilësisë së ajrit nga neni 9 i kësaj rregulloreje, dhe Raportin për zbatimin e planit afatshkurtër të veprimit nga neni 10 ia dërgon Ministrisë.

Neni 12

Informimi i publikut për Planin e Veprimit

1. Komuna, draftin final të Planit të Veprimit nga neni 9 i kësaj rregulloreje dhe Planit Afatshkurtër nga neni 10 i kësaj rregulloreje dhe Raportin nga neni 11 paragrafi 2 i kësaj rregulloreje, duhet t'i publikojnë në ueb faqet e saj për marrjen e mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve eventuale.
2. Komuna informon publikun përmes mediave për vendin në të cilin janë publikuar dokumentet nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe për mënyrën dhe kohën e dhënies së mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve.
3. Afati për dhënien e mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë, nga dita e publikimit.
4. Komuna për dokumentet nga paragrafi 1 i këtij neni i shqyrtojnë mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna dhe vlerësojnë arsyeshmërinë e tyre.

KAPITULLI VI

ZONAT ME MBROJTJE TË VEÇANTË

Neni 13

Zonat me mbrojtje të veçantë

1. Zonat e caktuara të cilat i tejkalojnë vlerat kufitare të emisioneve të ndotësve në ajër, me propozim të Ministrisë, shpallen me vendim nga Qeveria si zona që kërkojnë mbrojtje të veçantë të ajrit, nga ndotja.
2. Për zonat me mbrojtje të veçantë në territorin e saj, Komuna do të përcaktojë masa të veçanta për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
3. Për të stabilizuar dhe përmirësuar cilësinë e ajrit, operatorët në atë zonë, duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë masa për zvogëlimin e ndotjes dhe masa parandaluese.
4. Operatorët duhet të informojnë periodikisht komunën për masat e ndërmarra për zvogëlimin e ndotjes dhe masa parandaluese.
5. Operatorët janë të detyruar ti përmbahen detyrimeve të përcaktuara nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni.

KAPITULLI VII

SISTEMI INFORMATIV PËR AJËR

Neni 14

Përmbajtja e Sistemit Informativ për Ajër

1. Të dhënat për cilësinë e ajrit nga stacionet monitoruese të nivelit lokal dhe matjet e veçanta të cilat sigurohen nga ndotësit dhe të dhënat e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme sipas lejeve komunale janë pjesë e Sistemi Informativ për Ajër;
2. Komuna është e obliguar të ia dërgojnë AMMK të dhënat e nevojshme për përditësimin e Sistemit Informativ të Ajrit dhe për hartimin e planit, programit dhe raportit.
3. Nëse Komuna posedonë të dhënat me rëndësi për menaxhimin e cilësisë së ajrit është e obliguar t'a dërgojnë ato AMMK-së në formë elektronike.

Neni 15
Qasja në informata

1. Të gjitha të dhënat e matjeve nga stacionet monitoruese në territorin e komunës, në formatin burimor dhe valid dhe shpeshhtësisë së matjeve, duhet të jenë në disponim për komunën për nevojat e menaxhimit të cilësisë së ajrit dhe hartimin të planeve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

KAPITULLI VII
INFORMIMI PËR CILËSINË E AJRIT DHE
SHKËMBIMI I INFORMATAVE

Neni 16
Informimi i publikut

1. Komuna informonë publikun, duke përfshirë shoqatat dhe organizatat për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konsumatorëve, shoqatat dhe organizatat të cilat përfaqësojnë interesat e shtresave të ndjeshme të popullatës, shoqatat ekonomike si dhe organet kompetente për mbrojtjen e shëndetit dhe shëndetit publik, për cilësinë e ajrit;
 - 1.1. zbatimin e planeve të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit;
 - 1.2. zbatimin e planeve afatshkurta të veprimit;
 - 1.3. raportin vjetor për ndotësit e ajrit.

KAPITULLI IX
FINANCIMI PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E CILËSISË
SË AJRIT DHE INSTRUMENTET EKONOMIKE

Neni 17
Financimi për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

1. Mjetet financiare për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës sigurohen Buxheti i Komunës si dhe burimeve të tjera financiare sipas dispozitave të këtij ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.
2. Mjetet nga paragrafi 1 të këtij neni përdoren për financimin e:
 - 2.1 hartimit dhe zbatimit e planit lokal të veprimit për cilësi të ajrit, dhe planit afatshkurtër të veprimit;
 - 2.2 stacioneve matëse dhe matjeve për qëllime të veçanta
 - 2.3 masave për mbrojtjen e popullatës gjatë shfaqjes së pragjeve të alarmit;
3. Burime tjera financiare të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë: burimet e ndotësve, grantet, kredit, fondet mbështetëse të Qeverisë, fondet e ndihmës

ndërkombëtare, fondet e investimeve të huaja të destinuara për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

KAPITULLI X

MBIKQYRJA INSPEKTUESE

Neni 18

Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen Inspektori mjedisor i Komunës.

Neni 19

Subjektet e mbikëqyrura në procedurë të inspektimit

1. Subjektet e mbikëqyrura në procedurën e inspektimit lidhur me zbatimin e kësaj rregullore janë:

1.1. ndotësit e specifikuar në kuadër të lejes mjedisore komunale;

1.2. personi juridik i cili kryen veprimtarinë e monitorimit të cilësisë së ajrit në nivel lokal,

1.3. personi juridik i cili kryen monitorimin e emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme dhe verifikimin e sistemit matës për matjen e vazhdueshme të emisioneve të ndotësve nga burimet e palëvizshme sipas lejeve mjedisore komunale;

1.4. personi juridik ose fizik - operatori i impiantit i pajisur me leje mjedisore komunale.

Neni 20

Autorizimet e inspektorit mjedisor komunal

1. Në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, inspektori mjedisor komunal është i autorizuar dhe ka të drejtë qasje në aktet e përgjithshme dhe të veçanta, monitoron kushtet dhe mënyrën e punës së personave të mbikëqyrur dhe ndërmerr masat e parashikuara me këtë rregullore, Ligjin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe aktet nënligjore.

2. Gjatë zbatimit të mbikëqyrjes inspektuese inspektori mjedisor komunal kontrollon:

2.1. zbatimin e masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të përcaktuara në vendimin e Lejes Mjedisore Komunale;

Neni 21

Të drejta dhe detyrat e inspektorit mjedisor

1. Në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, në rastin e moszbatimit të kësaj rregullore, Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe akteve nënligjore inspektori mjedisor komunal ka të drejtë dhe detyrë që personit të mbikëqyrur, me vendim, t'i caktoj afat për përmbushjen e masave për:
 - 1.1. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit nga vendimi i Lejes Mjedisore Komunale;
 - 1.2. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit të dala nga Plani Lokal i Veprimit;
 - 1.3. zbatimin e masave për mbrojtjen e ajrit të dala nga Plani Afatshkurtër i Veprimit dhe ndërmarrjen e veprimeve tjera me qëllim të parandalimit të ndotjes së ajrit.
2. Inspektori mjedisor komunal me vendim do t'i urdhëroj personit të mbikëqyrur zbatimin e masave nga vendimi i Lejes Mjedisore Komunale, nëse nuk i zbaton ato.
3. Inspektori mjedisor komunal me vendim urdhëron ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë në rast të mos zbatimit të masave sipas vendimit të Lejes Mjedisore Komunale, deri në përmbushjen e këtyre masave.

Neni 22

Procedurat e Ankesës kundër vendimit të Inspektorit komunal

1. Procedura e ankesës kundër vendimit të inspektoratit komunal rregullohet me ligjin përkatës për inspektoratin e mjedisit

KAPITULLI XI

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 23

Ndëshkimet

1. Masat ndëshkimore të përcaktuara me këtë rregullore shqiptohen nga Inspektori mjedisor komunal.

Neni 24

Sanksionet kundërvajtëse me gjobë

1. Me gjobë prej njëzetmijë (20.000) euro, deri në dyzetmijë (40.000) euro dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse nuk siguron monitorimin e cilësisë së ajrit sipas vendimit të Lejes Mjedisore Komunale nenit 6 paragrafi 1 i kësaj rregulloreje;

2. Me gjobë prej katërqind (400) deri në katërmijë (4.000) euro dënohet personi përgjegjës i komunës, nëse nuk e miraton Planin Komunal të Veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas neni 9 të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI XIV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 26 Hyrja në fuqi

Ky rregullore hyn në fuqi që nga data e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.